

## PROCEDURAT E ANKIMIT

Prefekti i Qarkut Tiranë vepron në bazë të Ligjit Nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”

- Sipas Nenit 19 Shqyrtimi i ankesave dhe zgjidhja e konflikteve:

1. Prefekti i qarkut shqyrton ankesat e shtetasve për ligjshmërinë e akteve me karakter normativ të nxjerra nga organet e njësisve të vetëqeverisjes vendore. Në këto raste, i kërkon organeve të njësisve të vetëqeverisjes vendore depozitim të aktit përkatës te prefekti i qarkut, kur një gjë e tillë nuk është bërë më parë, ose zbaton procedurat e përcaktuara në nenin 16, të këtij ligji.

2. Ankesat e shtetasve shqyrtohen nga prefekti i qarkut sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative.

3. Prefekti i qarkut informohet për konfliktet që lindin ndërmjet:

- a) institucioneve të ndryshme, në nivel qarku;
- b) institucioneve dhe shtetasve, në nivel qarku.

Në këto raste, prefekti i qarkut ka detyrim të përfshihet në zgjidhjen e tyre, duke adresuar konfliktin pranë institucioneve përgjegjëse.

- Sipas Nenit 20 Vendimmarrja

1. Në zbatim të përgjegjësive të tij sipas këtij ligji, prefekti i qarkut nxjerr urdhra dhe udhëzime të detyrueshme për zbatim.

2. Aktet e prefektit të qarkut bëhen të zbatueshme pas marrjes së dëgjimit të subjekteve të cilave u drejtohen.

3. Në rastet kur lindin konflikte ndërmjet një ministrie ose drejtuesit të një institucioni qendror dhe prefektit të qarkut për urdhrat ose udhëzimet që ai ka nxjerrë, zgjidhja bëhet sipas përcaktimeve të nenit 9, të këtij ligji.

4. Për rastet e konflikteve të subjekteve, të papërmendura në pikën 3, të këtij neni, dhe prefektit të qarkut, palës së interesuar i lind e drejta t'i drejtohet gjykatës kompetente për çështjet administrative.

- Paraqitja dhe shqyrtimi administrativ i ankesës së qytetarit kryhet sipas dispozitave të Neneve 128 e vijues të Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.
- Paraqitja dhe shqyrtimi gjyësor i ankesës së qytetarit kryhet sipas dispozitave të Ligjit Nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, Kodit të Procedurave Administrative dhe Kodit të Procedurave Civile.
- Ankesa duhet të paraqitet duke plotësuar të gjithë elementët formal sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative. Ankimi administrativ ndaj aktit duhet të përcaktojë:

- a) subjektin që ushtron ankimin administrativ;
- b) organin që shqyrton ankimin administrativ;
- c) aktin administrativ, i cili kundërshtohet ose aktin administrativ të kërkuar, i cili nuk është nxjerrë;
- ç) objektin dhe shkaqet për të cilat bëhet ankimi.

Ankimi administrativ ndaj aktit administrativ duhet të paraqitet brenda 30 ditëve nga data kur ankuesi ka marrë njoftim për nxjerrjen ose refuzimin e nxjerrjes së aktit administrativ. Në rastin e mosveprimit administrativ, me përjashtim kur miratimi në heshtje është i zbatueshëm, ankimi duhet të paraqitet jo më parë se 7 ditë dhe jo më vonë se 45 ditë nga data e përfundimit të afatit të caktuar ose të shtyrë, për përfundimin e procedurës administrative.